



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502620/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë në favor të A dhe P.J. për pasurinë e rregjistruar me nr.3, faqe 47, indeksi 137, datë 07.03.1996, në rregjistrin hipotekor të ZVRPP, Sarandë, truall me sipërfaqe 334.7m2.*

Drejtuar : **Ardiana Shehu**
Rregjistruese e Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

SARANDË

Për dijëni : **Ministrisë së Drejtësisë**

Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme
Z.Ilirjan Muho

P.J.
Adresa: Lagja nr.1, Pallati nr.7,

SARANDË

Zj.Rregjistruese!

Institucioni i Avokatit të Popullit, sikurse jeni në dijëni ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit P.J., në të cilën prezantohet shqetësimi për mosdhënien e shërbimit të kërkuar për lëshimin e akteve të pronësisë për pasurinë truall me sipërfaqe 335m2, sikurse vendosur me Vendimin nr. 101, datë 08.12.1995, prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, ish-Pronarëve, Rrethit Sarandë, ndryshuar, me Vendimin Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1807, datë 22.11.2010, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me objekt midis të tjerave;

"... Konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të Vendimit nr.101, datë 08.12.1995, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, ish-Pronarëve, Rrethit Sarandë, për sipërfaqen 25.30m2, i cili ka mbivendosje me pronën e palës paditëse..."

Për këtë pasuri të regjistruar me nr.137, datë 07.03.1996, ZK 2806, konstatohet se ZVRPP, Sarandë, më datë 17.01.2007, ka lëshuar dokumentin e pronësisë, Vërtetim “Nga dokumentet hipotekor”, së bashku me hartën treguese të regjistrimit në favor të bashkëpronarëve A dhe P.J.

Për të mundësuar pajisjen me Çertifikatë “Për vërtetim pronësie” të ankuesit, mbi pasurinë në fjalë, Ju, në Shkresën nr.6311/1 prot, datë 15.06.2016, drejtuar Avokatit të Popullit, justifikoni moslëshimin e dokumenteve të pronësisë, për shkak të nxjerrjes prej parardhësit tuaj të Urdhërit nr.1156 Prot, datë 01.03.2013, “Për vendosjen e masës së kufizimit”, sipas të cilit është urdhëruar;

“Vendosja e masës së kufizimit mbi pasurinë e regjistruar në;

- 1. Regjistri hipotekor nr.3, faqe 47, ind/nr.137, datë 07.03.1996 “Truall me sipërfaqe 360m2, ndodhur në Fshatin Nivicë, ZK 2806, në pronësi të A dhe P.J..*
- 2. Të njoftohen palët e interesuara”.*

Zj. Regjistruese!

Në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenit 59 dhe 75 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, masa e kufizimit e vendosur sipas Urdhërit nr. 1156 Prot, datë 01.03.2013, prej organit që ju përfaqësoni, ka rënë, me rastin e kalimit të 30 ditëve nga data e njoftimit të tij palëve të interesuara, për rrjedhojë qëndrimi që është mbajtur dhe mbahet nga ana e ZVRPP, Sarandë, për lëshimin e dokumenteve të pronësisë për sipërfaqen e truallit 335m2, e cila nuk krijon mbivendosje me pasurinë e ndonjë subjekti tjetër, është i parregullt. Duhet kuptuar, zj.Regjistruese, se sipas Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1807, datë 22.11.2010, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, është vendosur për konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të Vendimit nr.101, datë 08.12.1995, të dhënë prej KKKP Ish-pronarëve, Rrethit Sarandë, për sipërfaqen 25.30m2, e cila ka mbivendosje me pronën 334.7m2 të palës ankuese, dhe jo për ndryshimin e së drejtës të pronësisë për gjithë sipërfaqen e truallit 334.7m2 të njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrës sipas Vendimit nr.101, datë 08.12.1995, të KKKP Ish-pronarëve, Rrethit Sarandë.

Duke qenë se mbivendosja e pronave për 25.3m3 është identifikuar në akt ekspertimin e kryer prej ekspertit të thirrur në procesin gjyqësor të zhvilluar, akt i cili është pjesë përbërëse e Vendimit Gjyqësor nr. 1807, datë 22.11.2010, ju zj.Regjistruese, në referim të parashikimeve të nenit 20, 28, 30, 31 dhe 59 të Ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, duhet të procedoni për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të ankuesit për sipërfaqen 334.7m2 truall, e cila nuk krijon mbivendosje me ndonjë pasuri tjetër kufitare.

Qëndrimi i mbajtur prej organit që ju përfaqësoni, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1807, datë 22.11.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Funksionimi i organit që ju përfaqësoni, në zbatimin e këtij vendimi gjyqësor, konstatohet se, nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit të mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave private, të parashikuara në Ligjin nr.44/2015, Kodi i Procedurës Administrative, dhe detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të Kodi.

Qëndrimin e derisotëm i mbajtur nga ana juaj e vlerësojmë në cënim të së drejtës së pronësisë, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar respektivisht në nenin 41, 42 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave në afat për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, si dhe për një zgjidhje ligjore të çështjes së prezantuar çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë në favor të A dhe P.J. për pasurinë e rregjistruar me nr.3, faqe 47, indeksi 137, datë 07.03.1996, në rregjistrin hipotekor të ZVRPP, Sarandë, truall me sipërfaqe 334.7m2.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të shkresës nr.6311/1 prot, datë 15.06.2016, të ZVRPP, Sarandë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të Urdhërit nr. 1156 prot, datë 01.03.2013, të nxjerr prej Regjistruesit të ZVRPP, Sarandë.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**